



Kolegji Riinvest

Zyra për planifikim akademik

## **Paraja dhe bankat EKOB404**

Profesori i lëndës	Alban HETEMI
Email	alban.hetemi@riinvest.net
Telefoni	+383 (0) 38 224 322
Asistentja e lëndës	Diandra NELA
Email	diandra.nela@riinvest.net
Telefoni	+383 (0) 38 224 322

### **Hyrje**

Lënda "Paraja dhe bankat" synon t'u ofrojë studentëve njohuri në fushën e parasë dhe bankave përmes sqarimit të një sërë konceptesh dhe kategorish bankare, të cilat u krijojnë atyre mundësinë për ta konceptuar sistemin financiar. Ky kurs synon t'iu jap njohuri më të thelluara në kuptimin e sjelljes së bankave dhe të adresojë disa nga trendët kryesore në bankingun e sotëm modern. Lënda është dizajnuar të analizojë ndikimin apo efektin e parasë dhe bankave në disa variabla kryesore ekonomike, siç janë: normat e interesit, normat e këmbimit valutor, inflacioni etj. Po ashtu, lënda trajton rolin e bankës qendrore në procesin e implementimit dhe zbatimit të politikës monetare. Lënda në fjalë mbulon segmentin e menaxhimit të bankave si dhe fitimin e tyre, duke iu ofruar studentëve njohuri edhe në interpretimin e performancës së bankave.

### **Qëllimet**

Qëllimi i lëndës "Paraja dhe bankat" është njohja e studentëve me rolin e rëndësishëm, që luajnë bankat dhe institucionet e tjera financiare si ndërmjetës financiar në ekonominë e një vendi. Kjo lëndë aftëson studentët me kuptimin e konceptit të parasë, historinë e parasë, normat e interesit, normat e këmbimit valutor, menaxhimin e bankave, rolin e politikës monetare si dhe ndikimin që ka kjo e fundit në indikatorët makroekonomikë në ekonominë e një vendi. Gjithashtu, qëllim i kësaj lënde është edhe njohja e studentëve me teoritë dhe praktikatat e përdorimit të teknikave bankare, mënyrat e funksionimit të bankave qendrore dhe bankave të nivelit të dytë.

## Rezultatet e pritura të lëndës

- Të fitoj shkathtësi konkurruese teorike dhe praktike të aplikueshme në fushën e bankingut
- Të kuptoj funksionimin e bankave dhe rolin e tyre në ekonominë e vendit
- Të kuptoj sjelljet e institucioneve financiare në përgjithësi e bankave në veçanti
- Të kuptoj rolin e bankave qendrore si dhe menaxhimin e politikës monetare
- Të kuptoj tregun e këmbimit valutor
- Të kuptoj dhe interpretoj normat e interesit
- Të kuptoj si dhe interpretoj përformancën e bankave

### Programi

Java	Tema	Aktivitetet
1	Pse duhet studiuar parinë, bankingun dhe tregjet financiare? Një përmbledhje dhe analizë e sistemit financiar Çka është paraja? Çka janë bankat dhe çfarë bëjnë ato?	Ligjërata dhe Ushtrime
2	Kuptimi i normave të interesit	Ligjërata dhe Ushtrime
3	Sjellja e normave të interesit	Ligjërata dhe Ushtrime
4	Rreziku dhe struktura e normave të interesit	Ligjërata dhe Ushtrime
5	Testi I	Mbajtja e testit
6	Fitimi dhe përforma e bankave	Ligjërata nga ekspertë të bankave
7	Tregu i këmbimit valutor	Ligjërata dhe Ushtrime
8	Bankat dhe menaxhimi i institucioneve financiare	Ligjërata dhe Ushtrime
9	Bankat qendrore dhe politika monetare	Ligjërata dhe Ushtrime
10	Procesi i ofertës së parasë	Ligjërata dhe Ushtrime
11	Mekanizmi i transmisionit të politikës monetare	Ligjërata dhe Ushtrime
12	Testi II	Mbajtja e testit

### Vlerësimi:

Nr.	Lloji	Përqindja	Oblig.	Përshkrimi
1	Pjesëmarrja	10		Cilësia e pjesëmarrjes është po aq e rëndësishme sa edhe vet pjesëmarrja. Prandaj, vlerësohet pjesëmarrja aktive, debatet/diskutimet në klasë dhe detyrat e shtëpisë që mund të jepen.
2	Ese	20		Ese e shkurtër në fushën e bankingut
3	Kolokvium I	35	Po	Testi i parë do të realizohet në javën e pestë
4	Kolokvium II	35	Po	Testi i dytë do të realizohet në javën e dymbëdhjetë

### Kushtet e përsëritjes:

Kushtet e përsëritjes së lëndës janë të bazuara në rregulloren e studimeve të Kolegjit Riinvest.

### Burimet:

1. Mishkin, F.S., SERLETIS, A, 2020. The economics of money, banking, and financial markets. Seventh Canadian Edition
2. Cecchetti, S.G., Schoenholtz, K.L. and Fackler, J., 2017. Money, banking, and financial markets (Vol. 4). McGraw-Hill/Irwin.
3. Mishkin, F.S., 2016. The economics of money, banking, and financial markets. Eleventh Edition, Columbia University.
4. Hubbard, R. Glenn, O'Brien Anthony Patrick, and Sumati Varma. Money, banking, and the financial system. Boston: Pearson, 2014.
5. "Paraja dhe Bankat" - Dr.Bujar Leskaj dhe Adriatik Kotorri, 2011
6. "Paraja dhe institucionet financiare" - Dr. Drini Salko dhe Dr. Orfea Dhuci

### Ndërtimi i ECTS-ve

Aktiviteti	Nr i oreve per Aktivitetin
Ligjerata:	45
Ushtrime:	30
L+U:	75
Seminar/praktike.:	0
Studim i vazhdushem:	115
Pregaditja e Provimit:	30
Pjesemarrja ne teste:	2
Pjesemarrja ne provimin final:	3
Me profesorin dhe asistentin:	0
Total Ore:	225
ECTS:	9